

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Liberi Si Nasce” SH.P.K

Ortakë themelues:

- **Zj. Andreina Quaranta**, shtetase italiane, e datëlindjes 26/03/1979, lindur në Melzo (MI), banuese në Rugën Misurina, n.25, San Dona di Piave, Venezia, Italia, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse pasaportës italiane Nr. YB2884218
- **Zj. Elisa Renaldin**, shtetase italiane, e datëlindjes 20/09/1974, lindur në Varese (VA), banuese në Rugën M. Buonarroti, n. 45, Gazzada Schianno, Varese, Italia, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse pasaportës italiane Nr. YB7203514

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 07.01.2025, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1
Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**Liberi Si Nasce**” sh.p.k
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2
Forma

Shoqëria tregtare “**Liberi si Nasce**” sh.p.k ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qendrore

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**Liberi Si Nasce**” sh.p.k do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqipëri.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Shitjet dhe shërbimi ndaj klientit, administrimi i tyre.
- Retreat, Team Building dhe aktivitetet në salla dhe në vende të ndryshme.
- Kryerja e studimeve ekonomiko-financiare, konsulence variabile dhe administrative.



- Shërbime konsulence kërkimore për studime investimi, hulumtime tregu dhe analiza për investime, konsulencë marketingu online/offline, reklama.
- Shitja e hapësirës reklamuese për publikimet e veta dhe për llogari të palëve të treta, duke përfshirë agjencitë dhe/ose kompanitë e tjera.
- Hulumtimi i tregut, identifikimi i konkurrentëve dhe kërkimi i klientit.
- Kryen aktivitete konsulence dhe koordinuese teknike, financiare dhe administrative.
- Hulumtimi dhe analiza e tregut për investime, prodhim, shkrim dhe botim librash, revistash, studimesh teatrore, konsulencë financiare, konsulencë për teatër dhe kinema, organizim eventesh.
- Organizimi i konferencave, kongreseve, eventeve online dhe live, eventeve argëtuese, kurseve, praktikave dhe seminareve të llojeve të ndryshme, që synojnë individë, kompani, kompani, organizata, institute dhe organizma.
- Kompania mund të menaxhojë buxhetet e reklamave.
- Veprimtari editoriale duke përfshirë radio, televizion, telematik, dixhital dhe online.
- Komunikimi, marketingu, marrëdhëniet e jashtme, aktivitetet sociale dhe dixhitale.
- Inicimi dhe zhvillimi i panairove të kompanive, fushatave promovuese dhe përfshirja e investitorëve vendas dhe të huaj në çështjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

NENI 5 ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6 ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare “**Liberi Si Nasce**” sh.p.k mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brënda dhe jashtë vendit.

NENI 7 ***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “**Liberi Si Nasce**” sh.p.k
Përgjegjësia e ortakëve është e kufizuar në vlerën e aksioneve që ata kanë kontribuar në shoqëri.

NENI 8 ***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Liberi Si Nasce**” sh.p.k është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakët:

Zj. Andreina Quaranta – 1 kuotë – 50% me vlere 50.000 (pesëdhjetë mijë lekë)

Zj. Elisa Renaldin – 1 kuotë – 50% me vlere 50.000 (pesëdhjetë mijë lekë)

NENI 9 ***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

Administrator i shoqërisë do të jetë **Zj. Andreina Quaranta**.

NENI 11
Sekreti tregtar

Ortakët, administratorët dhe punëmarrësit e shoqërisë “**Liberi Si Nasce**” sh.p.k përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12
Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim.

Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Zj. Andreina Quaranta

Zj. Elisa Renaldin